

NË EMER TË POPULLIT

Gjykata e Apelit e Kosovës-Departamenti për Krime të Rënda, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Tonka Berishaj, kryetare, Fillim Skoro e Have Haliti, anëtar, me bashkëpunëtorin profesional Eroll Gashi, si procesmbajtës, në lëndën penale kundër të akuzuarve Q.I., nga Prishtina dhe H.N., nga Fushë Kosova, për shkak të veprës penale të kryer në bashkëkryerje marrja e rryshfetit, nga neni 343 par.2 lidhur me nenin 23 të KPK, duke vendosur sipas ankesave të akuzuarit Q.I., dhe mbrojtësit të akuzuarit H.N., av.B.SH., të ushtruara kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore-DKR në Prishtinë, PKR.nr.179/2015, të datës 12.06.2018, në seancën e Kolegjit të mbajtur me 05.11.2018, morri këtë:

AKTGJYKIM

I. Përkitazi me ankesën e mbrojtësit të akuzuarit H.N. av.B.SH. dhe të ankesës të akuzuarit Q.I., e sipas detyrës zyrtare, ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore- DKR në Prishtinë, PKR.nr.179/2015, të datës 12.06.2018, ashtu që ndaj të akuzuarve Q.I. dhe H.N., refuzohet akuza, për veprën penale marrja e rryshfetit, nga neni 343 par.2 e në lidhje me nenin 31 të KPK-se, për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale në baze të nenit 363 par 1 nën par.1.3 në lidhje me nenin 107 par.8 të KPRK-se.

II. Ankesa e mbrojtësit të akuzuarit H.N., avokatit B.SH. dhe ankesa e të akuzuarit Q.I., paraqiten si jo lëndore.

III. I dëmtuari D.R., për realizmin e kërkesës pasurore-juridike, udhëzohet në kontest civil.

Arsyetim

Me aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës Themelore-DKR në Prishtinë, të akuzuarit Q.I. dhe H.N., janë shpallur fajtor për veprën penale të kryer në bashkëkryerje marrja e rryshfetit, nga neni 343 par.2 lidhur me nenin 23 të KPK, dhe janë gjykuar secili veç e veç me dënim me burgim në kohëzgjatje prej nga 3(tre)muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse të njëjtit në periudhën prej nga 1(një)viti nuk kryejnë vepër tjetër penale.

I dëmtuari D.R., për realizmin e kërkesës pasurore-juridike, është udhëzuar në kontest civil.

Të akuzuarit Q.I. dhe H.N., janë obliguar që të paguajnë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë së kësaj gjykate, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën prej nga 50(pesëdhjetë)Euro, secili veç e veç, në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjyqimit.

Kundër këtij aktgjykimi me kohë kanë ushtruar ankesë:

-I akuzuari Q.I., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe vendimit lidhur me sanksionin penal, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe i akuzuari të lirohet nga akuza.

-Mbrojtësi i të akuzuarit H.N., av.B.SH., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe i akuzuari të lirohet nga akuza apo i njëjti të anulohet dhe çështja penale të kthehet në rigjykim e vendim.

Prokuroria e Apelit-DKR në Prishtinë, me shkresën e saj PPA/I.nr.440/2018, të dt.24.09.2018, duke u sqaruar përkitazi me ankesën e të akuzuarit Q.I. dhe mbrojtësit të akuzuarit H.N., av.B.SH., me shkrim propozoi që aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet, ndërsa ankesat e ushtruara të akuzuarit Q.I. dhe mbrojtësit të akuzuarit H.N., av.B.SH., të refuzohen si të pabazuara.

Gjykata e Apelit, në bazë të nenit 394 par.1 të KPP, duke vlerësuar pretendimet ankimore të akuzuarit dhe mbrojtësit të akuzuarit, edhe sipas detyrës zyrtare, e bashkë me te edhe aktgjykimin e ankimuar, e duke marr parasysh edhe mendimin me shkrim të paraqitur nga ana e Prokurorisë së Apelit-DKR në Prishtinë dhe pas vlerësimit dhe shqyrtimit të gjitha shkresave të lëndës gjeti se:

Përkitazi me ankesën e mbrojtësit të akuzuarit H.N., av.B.SH., dhe të ankesës së të akuzuarit Q.I., e sipas detyrës zyrtare, aktgjykimi i ankimuar duhet të ndryshohet me refuzimin e akuzës ndaj të akuzuarve, për veprën penale marrja e rryshfetit, nga neni 343 par.2 e ne lidhje me nenin 31.te KPK-se, për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale në bazë të nenit 363 par.1 nën par.1.3 ne lidhje me nenin 107 par.1 dhe 8 te KPRK-se.

Duke e shqyrtuar aktgjykimin e ankimuar detyrimisht në pajtim me dispozitën e nenit 394 par. 1 nën par. 4 të KPP, lidhur me shkeljet e ligjit penal konform dispozitës së nenit 383 par.1 të KPP, si bazë ankimore, Gjykata e Apelit, gjen se këtë çështje penale aktgjykimi është mbështetur me shkeljen e ligjit penal, nga neni 385 par.1 nën par.1.3 të KPP. Nga shkresat e lëndës objekti i akuzës është vepra penale e kryer në bashkëkryerje marrja e rryshfetit, nga neni 343 par.2 lidhur me nenin 23 të KPK, për këtë vepër penale është paraparë dënimi me burgim prej 3(tre)muajve deri në 3(tre)vjet. Sipas dispozitës së nenit 106 par.1 nën par.1.5 të KPRK, është paraparë se ndjekja penale nuk mund të ndermirret, për veprat penale për të cilat me ligj është paraparë (3) vjet burgim nga kryerja e veprës penale të dënueshme me shume se (1) vit burgim , duke llogaritur prej ditës së kryerjes së veprës penale, ndërsa sipas dispozitës së nenit 107 par.8 të KPRK, është paraparë se ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit, pra, në këtë çështje penale dyfishi i kohës është 6(gjashtë)vite, pra, aq sa që me ligj kërkohet për parashkrimin e ndjekjes penale.

Sipas vlerësimit të kolegjit të Gjykatës së Apelit, me qëllim të evitimit të shkeljes së ligjit penal, e duke marrë parasysh se vepra penale është kryer me dt.20.10.2012, aktgjykimi i ankimuar është marrë me dt.12.06.2018, ndërsa në kolegjin penal çështja penale e njëjtë është ndarë në punë, me dt.16.10.2018, tri ditë para kalimit të dyfishit të kohës sa që kërkohet me ligj për parashkrimin e ndjekjes penale, e gjerë në vendosjen e kësaj çështje penale prej kohës se kryerjes se veprës penale prej datës 20.10.2012 e gjer me datën .05.11.2018, kanë kaluar 6(gjashtë)vite e 16(gjashtëmbëdhjetë)ditë, e nga kjo rezulton se ka kaluar dyfishi i kohës, pra, aq sa kërkohet me ligj për parashkrimin e ndjekjes penale, ndërkaq kjo prezanton rrethanën që e përjashton ndjekjen

penale dhe për shkak të kësaj rrethane, aktgjykimi është mbështetur në shkeljen e ligjit penal konformë dispozitës së nenit 385 par.1 nën par.1.3 të KPP. Prandaj, Gjykata e Apelit, me rastin e shqyrtimi të aktgjykimit të ankimuar përkitazi me ankesat e të akuzuarit Q.I. dhe mbrojtësit të akuzuarit H.N., av.B.SH., e meqë vërtetoi ekzistimin e kësaj shkeljeje të ligjit penal, andaj, detyrimisht ndryshoj aktgjykimin e ankimuar, duke refuzuar akuzën ndaj të akuzuarve të cekur më lartë, për veprën penale marrja e rryshfetit, nga neni 343 par.2 të KPK, e në bazë të nenit 363 par.1 nën par.1.3 të KPP.

Ankesa e mbrojtësit të akuzuarit H.N. av.B.SH. dhe të ankesa të akuzuarit Q.I. paraqiten si jo lëndore për arsye se çështja penale është parashkuar.

Nga se u cekë edhe më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e në bazë të nenit 403 par.1 nën par.1.2 të KPP të Kosovës.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.464/2018, me dt.05.11.2018

Procesmbajtësi,

Eroll Gashi

Anëtarët e Kolegjit

Fillim Skoro

Have Haliti

Kryetare e Kolegjit

Tonka Berishaj